



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK DROPULL

Nr. Prot.

Jorgucat, me 29/04/2022

PROÇES-VERBAL

TAKIM MË DATË:29.04.2022

Tema: Mbledhja e radhes te Keshillit Bashkiak Dropull te muajit Prill 2022,

Ora e hapjes te mbledhjes ora 10:30

Kryetari i Këshillit ,Kryesuesi i mbledhjes është znj.Donika Bauçi.

Këshilltar të pranishëm në mbledhje:

Donika Bauçi, ,Jorgo Luleme,Vasiliqi Nika, ,Orest Malo,Alketa Basho, ,Angjeliqi Praso,Fotaq Zhonga,Kostandina Doko, Eliona Mano,Violeta Ndrico,Anastas Iso,

Mungesat:Dhimiter Koça,Elefteria Karanxha, Marjeta Xhumba, Zhaneta Dralo,Llaokrat Konomi,Eliona Dhima,Kristo Varsami, Maksi Qëndro, Luljeta Pirali,Theodhori Dhima

Kryetari Keshillit deklaroi kuorumin 11 keshilltar,miratojme rendin e dites.

Te pranishëm në mbledhje Nenkryetari I Bashkise z.Dhefto dhe Z.Lulo,drejtorat z.Arjan Tusha dhe znj.Lindita Xhumba, znj,Thala Pulla, z,Llambi Ngjelo,

Kyesuesi i mbledhjes:

Miratojme procesverbalin e mbledhjes se muajit Mars me 11 vota pro,

Miratojme rendin e dites si meposhte,

Kryetare Keshillit kalojme tek pika 3 e rendit te dites,

Drejtori i Finances prezantoi raportin e performances te vitit 2021

Megjithese gjate muajit shkurt 2022 kemi kaluar monitorimin thekson znj.Thala Pulla tani do bejme nje prezantim te raportit te performances,

Te ardhurat e 2021 plani 665,891,fakt 587,367 ,realizim 83%,investime 2021,plan 463,969,fakt 371,357,realizim 80%,

Pika 4: Informacion nga zyra e Kultures dhe turizmit.

Fjalën e merr z.Spiro Kallo,i cili lexoi raportin per turizmin

Keshilltaret dolën me pyetjen: çfare pune do te behet nga zyra per te sjelle turiste?

Pergjigjet z.Spiro Kallo:Ne zyren tone po punohet per hartimin e nje broshure te potencialit kulturor dhe turistik ,te krahines tone,nje fletepalosje informuese,per te gjithë krahinen dhe fshatin turistik Sotire,

Kryetare e mbledhjes:Kalojme te pika 5 e rendit te dites.

Pika 5 e rendit te dites:Projekt-Vendim “ Për miratimin e përfituesve te fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmes ekonomike ”

Relaton z.Lengo:Per ndryshimet ne muajin Prill hiqet Evdhoksia Bako,shtohen Niqifora Laro,Majlinda Gogoni

Kryesuesi i mbledhjes kryetari i keshillit deklaroi hapjen e votimit per perfitimin e fondit shtese mbi fondin e kushtezuar te ndihmes ekonomike,votojne 11 keshilltare pro,kundra ska,pra miratohet,

Pika 6 e rendit te dites:Projekt-Vendim “Per miratimin e transferimeve buxhetore”.

Z.Lengo lexon relacion “Per miratimin e transferimeve buxhetore’ per shtesat dhe pakesimet extrovert roat 2100,sociale CTR 2021/425-719,2100 shtuar ,per pagesen e tatimit te vleres te shtuar,Tek projektet shtohen shpenzimet:

Të pakesohen shpenzimet:

-Gr.00.Tit.04260 .Kap.5.Art .602 për	4.400.000 lek
-Gr.00.Tit.04520 .Kap.5.Art .602 për	2.800.000 lek
-Gr.00.Tit.04520 .Kap.5.Art .231 për	2.100.000 lek
- Gr.00.Tit.04980. Kap.1.Art.609 për	602.905 lek
Totali	9.902.905 lek

Kryesuesi deklaroi hapjen e votimit ,votojne 11 keshilltare pro,kundra ska,pra miratohen transferimet buxhetore,

Pika 7 e rendit te dites:P/Vendim "Per miratimin e parcelave kullosore ku do të grumbullohen bimë mjekësore eterovajore e tanifere natyrore dhe sasia e bimëve sherebel e rigon sipas ekonomive kullosore pronë e bashkise Dropull dhe koha e lejueshme e grumbullimit te tyre"

I jepet fjala drejtorit te kullotave:

Drejtori I kullotave lexon raportin teknik dhe tabelat permbledhese per bimet medicinale

Keshilltaret ngren shqetesim per çrrenjosjen e bimeve medicinale.

Sipas tabelës të ardhurave për bashkinë janë të pakten 200,000leke ,

Keshilltari Jorgo Luleme thote: Te kontrollohen ne vjeljen e tyre te mos çrrenjosen ,

Hedhim ne vote projekt vendimin P/Vendim "Per miratimin e parcelave kullosore ku do të grumbullohen bimë mjekësore eterovajore e tanifere natyrore dhe sasia e bimëve sherebel e rigon sipas ekonomive kullosore pronë e bashkise Dropull dhe koha e lejueshme e grumbullimit te tyre"

Pra miratohet projektvendimi me 11 vota pro,kundra ska,

Relaton Kryetare e keshillit :Per kerkesen e ndryshimit te stacionit nga qendra e Bashkise ne seline e shoqerise ne Kakavi,

Keshilltaret u shprehen: Jemi te mendimit te mos jepet ndryshimi i stacionit nga qendra e Bashkise ne Kakavi.

Votojne 11 keshilltare pro, per mos ndryshimin e vendimit te stacionit ,

Mbledhja deklarohet e mbyllur,